



Data: 18.05.2018

Ref.: 497/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa nr.638/17 e datës 07.09.2017 e Kolegjit “Pjetër Budi”. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr. 677/17 i datës 11.08.2017.

A r s y e t i m i

Kolegji “Pjetër Budi” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim nr.638/17 e datës 07.09.2017 të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) 677/17 i datës 11.08.2017 në lidhje me mos akreditimin e programit të studimit BSc Shkenca Kompjuterike.

Pas shqyrtimit të kërkesës KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të Kolegjit “Pjetër Budi”. KSHC konsideroi se gjendja faktike e Kolegjit “Pjetër Budi” në kohën e marrjes së vendimit të KSHC-së është trajtuar me saktësi nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe nga KSHC. Gjendja faktike e Kolegjit Pjetër Budi për programin e studimit Shkenca Kompjuterike BSc është prezantuar me saktësi në raportin e vlerësimit të jashtëm në përputhje të plotë me UA për Akreditim i cili ka qenë në fuqi në momentin e marrjes së vendimit.

Duke pasur parasysh arsyet e cekura më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 131, të Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr. 05/L-031. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Pjetër Budi"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

